



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

KOMISIONI PËR EKONOMINË DHE FINANCAT

Tiranë, më 19.11.2018

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËFINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR POPULLSINË”

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në mbledhjen e datës 19 nëntor 2018, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë”. Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave dhe shqyrtohet sipas procedurave të parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e komisionit përgjegjës.

Në mbledhje ishin të pranishëm, për të paraqitur projektligjin dhe për të dhënë informacionet e kërkuara nga deputetët, Zëvendësministrja e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe përfaqësues të Institutit të Shëndetit Publik.

Marrëveshja është miratuar nga Këshilli i Ministrave në korrik 2018 dhe synon dhënien nga pala shqiptare të një kontributi financiar, prej 22.5 milionë lekësh, për përfundimin e studimit demografik dhe shëndetësor në Shqipëri 2017-2018.

Raundi i parë i studimit demografik në fushën e shëndetësisë është kryer në vitet 2008-2009 dhe ka shërbyer për hartimin e politikave dhe strategjive mbi shëndetin. Me kalimin e viteve, lindi nevoja për kryerjen e një studimi tjetër, më të potë dhe me të dhëna të përditësuara në këtë fushë. Për këtë arsye, u miratua marrëveshja për kryerjen e studimit demografik dhe shëndetësor 2017-2018, me bashkëfinancim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe disa agjencive ndërkombëtare, të cilat janë Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA), Projekti

“Shëndet për të gjithë” (HAP) i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) dhe UN Women. Në kryerjen e këtij studimi marrin pjesë edhe Instituti i Shëndetit Publik dhe Instituti i Statistikave Zyrtare. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është drejtuese dhe përfituese kryesore e projektit. Studimi është në proces dhe nuk ka përfunduar ende.

Ky studim shërben për të nxjerrë dhe ofruar të dhëna demografike dhe shëndetësore për disa grupmosha dhe kategori të popullsisë, si fëmijët e moshës 0-5 vjeç, gratë shtatzëna, gratë e moshës riprodhuese dhe individët me moshë madhore. Këto të dhëna nuk ofrohen nga administrata apo nga studime të tjera. Të dhënat e këtij studimi do të ndihmojnë në modifikimin e programeve e politikave ekzistuese dhe hartimin e politikave e strategjive të reja për shëndetin e popullsisë, krahasimin e treguesve të periudhave të ndryshme, si dhe pasurimin e bazës së të dhënave në nivel kombëtar me tregues të rëndësishëm demografikë e shëndetësorë.

Kostoja fillestare e plotë e studimit demografik e shëndetësor 2017-2018 ishte rreth 1.4 milionë dollarë amerikanë ose rreth 167.1 milionë lekë. Në muajin gusht 2017 Komiteti Drejtues i ADHS analizoi punën studimore të kryer dhe konkludoi që vlera e parashikuar për t’u financuar ishte e pamjaftueshme. Për përfundimin e këtij studimi nevojitej një financim shtesë prej 300 mijë USD (ose 33.5 milionë lekë). Palët ranë dakord që ky financim të përballohej nga pala shqiptare (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) në shumën 22.5 milionë lekë dhe UNFPA në shumën 11 milionë lekë. Për të siguruar këtë financim, u nënshkrua marrëveshja që propozohet të ratifikohet me këtë projektligj, në të cilën parashikohet që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në rolin e donatorit, të japë një kontribut financiar prej 22.5 milionë lekësh për kryerjen e studimit demografik dhe shëndetësor 2017-2018. Ky kontribut do t’i jepet UNFPA, si administrues i procesit, pas ratifikimit të marrëveshjes. Kontributi do të jepet nga fondet e parashikuara në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe nuk do të sjellë efekte në buxhetin e shtetit.

Vlerësimi i Komisionit.

Komisioni është i mendimit që marrëveshja është rëndësishme, pasi krijon mundësinë për sigurimin e financimit shtesë të nevojshëm për përfundimin e studimit demografik e shëndetësor 2017-2018. Ky studim do të luajë një rol të rëndësishëm në pasurimin e bazës së të dhënave demografike në fushën e shëndetit publik, duke ndihmuar institucionet e ndryshme për hartimin e politikave dhe strategjive përkatëse.

Përfundim.

Mbështetur në këto argumente, Komisioni e miratoi projektligjin me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje.

RELATORE

Antoneta DHIMA

KRYETARI

Erion BRAÇE